



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 12976 Prot

Lezhë, më 29 / 06 /2022

VENDIM

Nr. 75, Datë 28 . 06 .2022

Për një ndryshim në VKB nr.177, datë 23.12.2021 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2022 dhe PBA-së 2022-2024”.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi :

1.Miratimin e një ndryshimi në vendimin e KB nr.177, datë 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Lezhë për vitin 2022”, si më poshtë:

1/a- Pakësohet :

- Gr.00, Prog.06140, Kap.01, Art.230 në shumën 8,085,320 lekë, në zëri “Studim-projekte”.
- Gr.00, Prog.09120, Kap.05, Art.602 në shumën 749,000 lekë, në zëri “Qira kopshtesh”.

1/b- Shtohet :

- Gr.00, Prog.01110, Kap.01, Art.602 për shumën 8,085,320 lekë.
- Gr.00, Prog.01110, Kap.05, Art.602 për shumën 749,000 lekë. Kjo shumë do të përdoret për likuidimin e detyrimit të Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë nr.720, datë 27.11.2018 dhe Vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër nr.18, datë 20.01.2021.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI  
ERNEST RAKAJ

Në mungesë dhe me autorizim  
ZV/KRYETARI  
NDUE LULI





Prot 12178/1,

DT 5-7-22

KB

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT LEZHË

SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE E FUNKSIONEVE TË DELEGUARA

Nr. 451/10 Prot.

Lezhë , më 04.07.2022

L ë n d a : Konfirmim vendimi

**KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË**

**Për dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË**

Bazuar në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pika 2, gërma b, ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 75, datë 28.06.2022 të Këshillit të Bashkisë Lezhë “Për një ndryshim në VKB nr. 177, datë 23.12.2021, Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe PBA-së 2022-2024”.

**PREFEKTI**

**Gjergj PRENDI**

